



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve me Likuidim Nr. 32 - Njësite e Vendosura në Tender Nr. 26
Transkosova Zyret në Prishtinë

Emri i NSh.-së	(NSH Transkosova “Ndërmarrja”) Emrat e mëhershëm: NSHT “Transkosova” Fi-819/89; PDS “Transkosovo” Fi-1569/90 dhe Fi-1123/91; DD “Transkosovo” Fi-6697/92; NTM Transkosova UNMIK Regjistrimi i Përkohshëm i Biznesit Nr 80267274
Lloji i shitjes	Shitja me Likuidim me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	Me 24 Maj 2017 në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë në Prishtinë
Regjistrimi i Ofertuesit	Deri 17 Maj 2017, në Zyrën Qendrore AKP-së
Depozita e Ofertës	Euro 20,000€
Vendndodhja e Aseteve	Aseti ndodhet në Lamela nr. 4, Zyret nr. 14, lagja Lakërishtë-Prishtinë Transkosova Zyret në Prishtinë, kanë sipërfaqe prej 220 m ² sipas listës së asetëve, ndërsa 206 m ² sipas matjeve në teren. Zyret sipas matjeve përbëhen prej përdhese (garazha me hyrje në katin e zyrave në sipërfaqe 31m ² dhe podrumit në sipërfaqe 124m ²) dhe katit të parë në sipërfaqe prej 51m ² . Nga dokumentacioni i posedimit kemi vendimin e Këshillit të Punëtorëve “Zetatrans” Podgoricë nr. 17851 të datës 27.12.1983 me të cilën lejohet shitja e lokalit afarist në Prishtinë dhe shkresa e “Zetatrans” e datës e 10.07.2006, drejtuar “Transkosovës” ku theksohet se “Zetatrans” SHA Podgoricë, si shitës, ka lidhur kontratë me 15.02.1984 me “Transkosovën” nga Mitrovica, si blerës, kontrata 515, mbi shitblerjen e objektit afarist në Prishtinë, Lakërishte, lamela nr. 4 ,lokali nr. 14. Kontratën e cila përmendet nuk gjendet në arkivin e ndërmarrjes dhe as nuk kemi mundur ta sigurojmë, andaj si dokument i posedimit mbetet lista e asetëve dhe ky njoftim. Kati i parë që përbëhet nga dy zyre, korridori dhe WC-ja është në gjendje mjaft të mirë. Garazha mund të jetë e shfrytëzueshme, kurse podrumi është në gjendje të keqe dhe aktualisht nuk mund të përdoret, sepse depërtojnë ujërat e shiut dhe kanalizimit.
<u>Përshkrimi i Aseteve Ndërtesat dhe tokat</u>	
Shfrytëzuesit	Ka pasë marrëveshje për qiradhënie. Por, pasi që pala nuk ka qenë i rregullt me pagesa është larguar. Çelësat e zyrës gjenden në ZR Mitrovicë.

Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marr parasysh natyrën e tyre. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dosjen elektronike dhe dokumentet për ofertim. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSh-në apo artikujt e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Këto të dhëna janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme të cekura në Rregullat e Tenderit të cilat mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: www.pak-ks.org.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Përshkrimi i Aseteve **Asetet tjera**

Me rëndësi : Do të jetë nën përgjegjësinë e blerësit potencial që të kryej hulumtimin e tij për shkak të situatës. As AKP, e as AL nuk pranon ndonjë përgjegjësi për shpenzimet ose barrën që rrjedhë nga kjo.

Detyrimet që do të barten

Nuk ka detyrime që do të transferohen tek pronari i ri. Megjithatë blerësi i ri duhet të marrë përsipër se taksa për përkthimin e pronës mund të aplikohet.

Foto/fotot **Ose informata të tjera** **Për asetet në shitje**



Informatat



Departamenti i Shitjes – Njësia e Marketingut
Agjencia Kosovare e Privatizimit
Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1255
Fax: +381 (0) 38 248 076
www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Rruga: Agim Ramadani nr. 23 (ish Rr. Ilir Konushevc Nr. 8)
10000 Prishtinë, Kosovë

Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marr parasysh natyrën e tyre. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dosjen elektronike dhe dokumentet për ofertim. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në apo artikujt e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Këto të dhëna janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme të cekura në Rregullat e Tenderit të cilat mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: www.pak-ks.org.